



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Kryetari i Komunës
01-Nr. 02-16-11392 /11
Kaçanik më 06/09.2011

Kryetari i komunës në bazë të nenit 2 të Rregullores Nr.08/2011 Për Organizimin dhe Përgjegjësin e Zyrave Komunale për Integrim Evropian si dhe nenit 3 të Rregullores Nr.02/2010 Për zyrat komunale për Komunitet dhe Kthim më 06/09/2011 merr këtë:

A K T V E N D I M
MBI FORMIMIN E ZYRËS KOMUNALE PËR INTEGRIME,KTHIM
DHE KOMUNITETE

I

Me këtë aktvendim formohet zyra komunale për Integritime Evropiane, Kthim dhe Komunitete e cila i raporton kryetarit të komunës dhe në përbërjen e vet ka:

- Udhëheqësin e zyrës për integritime evropiane ,kthim dhe integritim të komuniteteve,
- Koordinatorin e zyrës për kthim të qëndrueshëm, dhe
- Koordinatorin e zyrës për integritim të komuniteteve

II

Kompetencat dhe Autorizimet e zyrës dhe personelit sipas nenit i të këtij Aktvendim janë të përcaktuara në Rregulloret e potencuar në pjesën hyrëse të këtij aktvendimi dhe përshkrimin e detyrave të punës së këtyre zyrtareve që do të jetë pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi.

III

Struktura e zyrës do të ketë këtë përbërje të zyrtareve :

1. Udhëheqës i zyrës për integritime evropiane, kthim dhe komunitete emërohet znj. Hidajte Guri
2. Koordinator i zyrës për kthim të qëndrueshëm emërohet z.Vedat Dema ,ndërsa
3. Koordinator i zyrës për integritim të komuniteteve emërohet z. Hajrush Dullovi.

IV

Zyrtarët e emëruar në kuadër të kësaj zyre këto kompetenca do ti ushtrojnë krahas punëve dhe detyrave tjera të punës që i kanë sipas sistematizimit dhe përshkrimit të vendeve të punës, ky angazhim bëhet për shkak të mungesës së hapësirës për angazhim të zyrtarëve të veçantë për kryerjen e këtyre detyrave.

V

Funksionimi i kësaj zyre do të mbulohet nga programi buxhetor përkatës sipas planifikimit buxhetor për vitin 2012.

VI

Me këtë aktvendim njoftohen: Ministria e PB, Ministria e Integriteteve, Ministria e APL, zyrtarët e emëruar, Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim dhe arkivi komunës

**Kryetari i komunës
z.Xhabir Zharku**
